




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT PËR VITIN 2021

Prishtinë, qershor 2022

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të AKP kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Drejtori Menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Drejtori Menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Drejtori Menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Agjencisë Kosovare të Privatizimit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Agjencisë Kosovare të Privatizimit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit kemi vërejtur se procesi i menaxhimit financiar dhe kontrollit ishte përcjellë me mangësi. Mangësitë e identifikuara janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me tri (3) rekomandime. Prej tyre dy (2) janë rekomandime të reja dhe një është i përsëritur i cili ka të bëjë me menaxhimin e pasurive.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.1.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte 5,350,209€. Prej tyre janë realizuar 5,348,022€ gjatë vitit 2021. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 257 ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 240 të punësuar edhe tetë (8) anëtar të Bordit. Gjatë vitit 2021 nuk kishte punësime të reja. Kemi testuar 74 njësi mostre (teste substanciale dhe të pajtueshmërisë për transaksion) në vlerë prej 349,273€.

Çështja A1 - Parregullsi në menaxhimin e burimeve njerëzore

Gjetja

Bazuar në Ligjin për Zyrar Publik të Nënkapitulli 2 - Transferimi në Shërbimin Civil Neni 52- Transferimi i përkohshëm pika 1 -“Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori, në këto raste: 1.1. kur është në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 vjetëve”.

Në pesë (5) raste, kemi vërejtur se AKP (me vendime të menaxhmentit), në njësinë e negocimit direkt ka transferuar përkohësisht nëpunës (staf) për më shumë se gjashtë (6) muaj. Sipas zyrtarëve të AKP-së janë 20 raste të njëjta të të punësuarve në transfere të përkohshme për periudhën janar - dhjetor 2021. Edhe pse nga muaji nëntor 2021 kjo praktikë ishte ndërpre nga ana e AKP-së, dy raste si rezultat i këtyre vendimeve mbeten aktive deri në pjesën e parë të vitit 2022.

Po ashtu, në një rast kemi vërejtur se nuk ishte respektuar kontrata e punës për pagesën e nëpunësit bazuar në vendimin e menaxhmentit me nr.DM 381-2019, dt.04.09.2019, ku ishte aprovuar ngritja e pagës sipas kërkesës së të punësuarit. E njëjta kontratë është në fuqi nga dt.04.09.2019 (neni 2 kohëzgjatja e kontratës, me afat të pacaktuar), mirëpo i punësuarit nuk kishte gëzuar të drejtën e pagesës, që ishte caktuar në kontratë (neni 3 i kontratës-Pagesa) prej 611€ sipas gradës/hapit 6-9. Nëpunësi vazhdon të paguhet me gradën me të ulëte 6-11 apo 559€. Sipas zyrtarëve në AKP, veprim i ngjashëm është edhe tek tri (3) raste të tjera. Kjo kishte ndodhur për shkak të problemeve në procesimin e pagës në ministrinë e linjës. Për më tej këto vendime ishin anuluar në mars të vitit 2022.

Sipas zyrtarëve përgjegjës, pas themelit të Njesisë për negocim Direkt në fillim vitit 2019 janë bërë përpjekje të vazhdueshme për iniciimin e procedurave për rekrutim. Mirëpo për shkak se draft Rregullorja me ndryshime për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, që kërkohet të përshtatet me klasifikim e pozitave sipas Ligjit të për Zyrarët Publik, ende nuk është miratuar nga Bordi, ky proces ka mbetë si i pa realizuar deri me tani. Megjithatë AKP ka hasur në pengesa për iniciimin e procedurës së rekrutimit për pozitën në fjalë, ato kanë funksionuar me ushtrues detyre apo me transferim të përkohshëm.

Ndikimi

Lëvizjet e stafit përtej limiteve ligjore nga një departament në tjetrin, vështirësojnë menaxhimin e resurseve njerëzore (pagesën me kohë, vijueshmërinë, matjen e performancës) dhe vazhdimin normal të procesit të punës në interes të institucionit, brenda këtyre njësive. Më tej, transferimet e përkohshme të nëpunësve, duke kaluar prej një pozite në pozitën tjetër

nëpër periudha të caktuar të vitit, nuk sigurojnë angazhim të përkushtuar dhe përmbushje të plot të objektivave. Ndërsa, mosrespektimi i kontratës e dëmton nëpunësin në pagesë. e cila mund të këtë implikim financiar të pa parashikuar në të ardhmen.

Rekomandimi A1 Bordi i Drejtorëve të AKP-së me qëllim të mbarëvajtjes së institucionit dhe zhvillimin e aktiviteteve normale të të gjitha njësive, duhet të siguroj që respektohen kërkesat ligjore në lidhje me transferimet e përkohshme të stafit si dhe lidhjen dhe zbatueshmerinë e kontratave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.2 Çështjet e përbashkëta për kategori të caktuara ekonomike

Çështja A2 - Mos penalizimi i operatorëve ekonomik dhe mos vazhdimi i sigurisë së ekzekutimit

Gjetja

Marrëveshja kontraktuale e lidhur në mes të AKP-së dhe operatorit ekonomik e parasheh afatin kohor për furnizim.

Neni 30.06 i RRUOPP -së thekson "Sigurimi i ekzekutimit do të mbetet valid për një periudhë prej tridhjetë (30) ditësh pas kompletimit të kontratës".

Neni 13.1 i kontratës parasheh që, nëse ofruesi i shërbimeve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat ose të realizojë shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0.25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10% të vlerës totale të kontratës, për çdo ditë vonesë.

Në dy pagesa kemi vërejtur në vonesa në liferimin e furnizimeve si dhe skadim të sigurisë së ekzekutimit:

Në projektin "Furnizim me softuer, backup dhe pajisje për TI-ve", në vlerë 49,994€, kontrata ishte nënshkruar me datë 13.07.2021, ku afati i përmbushjes ishte 60 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës. Realizimi i furnizimeve në vlerën prej 42,749€ (dt. 01.12.2021) ishte bërë me vonesë (më shumë se 70 ditë vonesë mbi afatin 60 ditor të përcaktuar në nenin 2.1 të kontratës). Pavarësisht nga kjo, AKP nuk ka aplikuar vonesa /penalltë që parashihen në kontratë në vlerë prej 4,999€ (maksimum 10% e vlerës së kontratës). Më tej, kontrata nuk është realizuar plotësisht nga ana e operatorit ekonomik. Konkretisht kanë mbetur furnizime të porealizuara në vlerë prej 7,245€, përderisa siguria e ekzekutimit për këtë kontratë ka skaduar me 12 tetor 2021.

Kontrata për "Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informativë", në vlerë 14,368€, kontrata ishte nënshkruar me datë 27/10/2020, dhe afati i realizimit ishte 60 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës. Furnizimi në vlerë prej 2,166€ për këtë kontratë ishte pranuar me datë 03/02/2021 me 37 ditë vonesë. AKP nuk ka aplikuar penalltë për vonesa (rreth 200€) për mos liferim në kohë.

Në të dy rastet nga menaxherët e kontratave nuk është ofruar ndonjë dëshmi për shtyrjen e afateve.

Arsyeja e mos aplikimit të penaltive dhe mos vazhdimi i sigurisë së ekzekutimit ishte kontrolli dhe monitorimi jo i mirë i realizimit të kontratave dhe përcjelljes së validitetit të sigurisë së ekzekutimit. Si dhe mungesa e informimit me kohë me vendimet e KRPP-së nga ana e AKP-së.

Ndikimi

Vonesat në ofrimin e mallit dhe mos përmbushja e kontratave/furnizimeve, mund të ndikoj në performancën e organizatës dhe arritjen e objektivave të sajë. Për më tej, mos aplikimi i penaltive/gjobave për vonesë të furnizimeve

është mosrespektim i kushteve të kontratës dhe dëmtim i buxhetit të organizatës. Gjithashtu, implementimi i kontratës në mungesë të sigurisë së ekzekutimit përveç që është shkelje e kriterëve kontraktuale e njëjta rrit rrezikun që humbjet eventuale për ekzekutimin e projektit të mos mbulohen me një garancion.

Rekomandimi A2 Bordi i Drejtorëve të AKP-së duhet të rishikoj procedurat të cilat ndikojnë në funksionimin e kontrolleve të brendshme për të identifikuar arsyet e mos zbatimit të kërkesave të kontratës dhe të siguroj që dështimet e tilla nuk do të ndodhin në të ardhmen.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.3 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 72,677€, pasurive jokapitale është 154,766€, si dhe e stoqeve 6,500€. Kemi testuar 22 mostra për teste substanciale në vlerë 126,350€, gjithashtu kemi aplikuar teste të pajtueshmerisë për procedura.

Çështja B1 - Mos-funksionimi i sistemit e-pasuria

Gjetja Sipas rregullores 02/2013 për Menaxhimin e Pasurive jo Financiare neni 6, paragrafi 3 “pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet, në sistemin “e-pasuria”.

AKP edhe këtë vit ende nuk kishte arritur që të funksionalizojë sistemin e-pasuria. AKP viteve të mëparshme kishte kërkuar nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike (MPBAP) që të barten të gjitha shënimet në sistemin “E-Pasuria”, po ashtu kërkesa të njëjta ishin bërë edhe gjatë vitit 2021, mirëpo kërkesa ka rezultuar pa sukses. Megjithatë AKP aplikon një softuer të brendshëm për menaxhimin e pasurisë jokapitale dhe pasuritë regjistrohen në këtë aplikacion.

Sipas zyrtarëve, AKP vite më radhë ka tentuar të regjistroj pasuritë në sistemin e-pasuria, mirëpo funksionalizimi i këtij sistemi nuk është bërë ende.

Ndikimi Sistemi jo funksional i e-pasurisë sipas kërkesave rregullative për menaxhim të pasurive, ndikon në mos-përmbushjen e kërkesave ligjore për regjistrimin e pasurisë. Më tej, mos funksionimi i sistemit e-pasuria rrit rrezikun për informata të mangëta mbi gjendjen e pasurisë dhe mos prezentim të drejtë të tyre në pasqyrat vjetore financiare.

Rekomandimi B1 Bordi i Drejtorëve të AKP-së duhet të siguroj vazhdimin e bashkëpunimit aktiv me MPBAP, për eliminimin e mangësive në sistemin e-pasuria, përfshirë edhe bartjen e shënimeve të pasurive jo kapitale.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Burimet e fondeve	7,375,604	6,635,583	6,531,932	6,832,923	6,975,898
Grante Qeveritare - Buxheti	7,375,604	6,635,583	6,531,932	6,832,923	4,975,898
Te hyrat e dedikuara	0	0	0	0	2,000,000

Buxheti përfundimtar është më i ulët se buxheti fillestar për 740,022€. Ndryshimet buxhetore kanë ardhur si rezultat i rishikimit buxhetor dhe pesë vendimeve të qeverisë: me nr.02/43, nr.14/44 dhe nr.02/48, nr.21/50, dhe nr.11/52, për kursime dhe ndarje në kategoritë e shpenzimeve në organizatat buxhetore.

Në vitin 2021 AKP-ja ka shpenzuar 98% të buxhetit përfundimtar ose 6,531,932.29€ me një zvogëlim prej 5% në krahasim me vitin 2020. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	7,375,604	6,635,583	6,531,932	6,832,923	6,975,898
Pagat dhe mëditjet	5,350,236	5,350,209	5,348,022	5,348,346	5,225,577
Mallrat dhe shërbimet	1,837,368	1,176,426	1,079,742	1,367,926	1,624,097
Komunalitë	98,000	64,974	61,419	50,105	63,598
Subvencionet dhe transferet	40,000	0	0	33,066	39,996
Investimet Kapitale	50,000	43,974	42,749	33,480	22,630

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për mallra dhe shërbime krahasuar më buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 660,941€. Ndryshimet kanë ndodhur me Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit mbi ndarjet Buxhetore për vitin 2021 (zvogëlim për 356,500€) dhe me dy vendime të Qeverisë nr.21/50 të datës 23.12.2021 dhe nr.02/48 të datës 23.12.2021 (zvogëlim për 304,441€);
- Buxheti final për shërbime komunale krahasuar më buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 33,027€. Ndryshimet kanë ndodhur me vendim të Qeverisë nr.21/50 të datës 15.12.2021;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 40,000€. Ndryshimet kanë ndodhur me Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit mbi ndarjet Buxhetore për vitin 2021 (zvogëlim për 20,000€) dhe me dy vendime të Qeverisë nr.14/44 të datës 10.11.2021 dhe nr. 21/50 të datës 23.12.2021 (zvogëlim për 20,000€) ; dhe
- Buxheti final krahasuar për investime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 6,026€. Ndryshimet kanë ndodhur me vendim të qeverisë nr.21/50 të datës 23.12.2021.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2021




Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Pranimet	2020 Pranimet	2019 Pranimet
Totali i të hyrave	0	0			1,036,241
Të hyrat jo tatimore	0	0			1,036,241

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2021 të AKP-së ka rezultuar në pesë (5) rekomandime kryesore. AKP kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2021, kater (4) rekomandime janë zbatuar, një (1) rekomandim nuk ishte zbatuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që të gjitha kontratat e nënshkruara të publikohen në platformën e prokurimit elektronik, konform kërkesave të ligjit dhe rregullave të zbatueshme.	Nga mostrat e testuara nuk kemi identifikuar ndonjë rast të tillë.	I zbatuar
2.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se nënshkrimi i kontratave bëhet brenda afateve ligjore. Në rast se nënshkrimi i kontratave tejkalon kohën e validitetit të tenderit, nga OE duhet të kërkohet zgjatja ose ri-konfirmimi i validitetit të tenderit.	Nga mostrat e testuara nuk kemi identifikuar ndonjë rast të tillë.	I zbatuar
3.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalitë	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që procedurat e vlerësimit të tenderëve të realizohen sipas afateve të parapara me qëllim që të eliminohen dyshimet lidhur me vonesat, në mënyrë që furnizimet të realizohen në kohën e duhur.	Gjatë testeve tona kemi vërejtur se vlerësimi i tenderëve edhe këtë vit nuk bëhet sipas afateve, ndërsa sa i përket kriterëve të vendosura në dosje të tenderit nga mostrat e testuara nuk kanë tejkaluar kufizimet e përcaktuara me rregullat e prokurimit	I zbatuar
4.	Pasuritë	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj vazhdimin e bashkëpunimit aktiv me MPBAP, për eliminimin e mangësive në sistemin e-pasuria, përfshirë edhe bartjen e shënimeve të pasurive jo kapitale.	Nga mostrat e testuar kemi vërejtur se ende nuk ka filluar përdorim i sistemit e-pasuria.	Nuk ka filluar zbatimi
5.	Pasuritë	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se janë evituar shkaqet që paraqesin vonesa në procesin e inventarizimit të pasurisë, në mënyrë që raporti i komisionit të finalizohet dhe harmonizimi i regjistrave të përfundohet para përgatitjes së PFV, që të sigurohet se vlera e pasurisë të prezantohet e plotë dhe e saktë.	AKP ka formuar komisionin për inventarizim dhe ka kryer të gjitha regjistrimet e fund vitit dhe po ashtu ka bërë krahasimin e gjendjes së pasurisë sipas raportit të inventarizimit me gjendjen e regjistrave të pasurisë.	I zbatuar


Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Naser Arllati, Ndhmës Auditor i Përgjithshëm




Jusuf Kryeziu, Drejtor i Auditimit



Valbona Tolaj, Udhëheqëse e ekipit



Shefkije Beka, Anëtare e ekipit



Luljeta Morina, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

Letër Konfirmimi



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për vitin 2021 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- Pas takimit dhe diskutimeve me ekipin e ZKA, lidhur me të gjeturat, pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.


Avni J. Jashari
Zëvendësues i Drejtorit Menaxhues
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Data: 31 maj 2022

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Matrica e testimit për pasuritë -pajtueshmeria, 0,00 €, Edhe në këtë vit nuk funksionon e-pasuria, për kundershtet perpjekjeve të mëshme nga AKP.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.